

## **Delegacionet e Prishtinës dhe Beogradit diskutojnë për decentralizimin**

**Vjenë** – Delegacionet nga Prishtina dhe Beogradi sot në Vjenë kanë mbajtur raundin e pestë të bisedimeve të drejtpërdrejta për decentralizimin në Kosovë. Bisedimet u mbajtën nën drejtimin e Emisarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, z. Martti Ahtisaari, dhe u përqendruan në parimet e decentralizimit, komunat e reja me shumicë serbe në Kosovë dhe në çështjen e Mitrovicës. Takimi, i cili u mbajt në një formë të “bisedimeve për përafrimin e qëndrimeve”, vazhdoi pas një takimi të shkurtër plenar dhe u kryesua nga z. Bernhard Schlagheck, këshilltar i lartë i UNOSEK-ut.

Z. Schlagheck tha se diskutimi ka rezultuar me një “ndryshim thelbësor mbi të gjitha çështjet lidhur me decentralizimin dhe disa i kanë mirëpritur rezultatet, në veçanti ato mbi caktimin e parimeve” të krijuara nga UNOSEK-u. Ai tha se ne disi e mbyllëm zbrazësinë, i identifikua fushat kryesore të problemeve dhe deri në një masë mosmarrëveshjet dhe, ne të gjithë e kemi kuptuar më mirë se ku qëndron secila palë në këtë çështje shumë komplekse.

Z. Schlagheck tha se “Delegacioni i Beogradit ka pengesa në fushat e kompetencave, në veçanti në shkallën e përfshirjes së komunave në polici dhe drejtësi, në planprogramet për sistemin e arsimit dhe në strukturën për gjuhën serbe në universitet; për Prishtinën në çështjen e decentralizimit asimetrik”, përkatësisht në atë nëse duhet dhënë kompetenca shtesë komunave të Kosovës me shumicë serbe.

Z. Schlagheck konstatoi se Prishtina ka bërë një “lëvizje të mirëpritur me ofrimin e dy komunave të reja në Partesh dhe në Klokot – Vërbovc”. Ai tha se Delegacioni i Beogradit ka treguar pak fleksibilitet në “komunat standarde”, por duket se janë të gatshëm të bëjnë lëvizje lidhur me “komunat e kthimit” apo lidhur me disa raste të veçanta dhe se Beogradi ka reduktuar gjithashtu numrin e komunave me shumicë serbe në Kosovë nga numri i kërkuar i komunave në fillim. Z. Schlagheck tha se ka pasur gjithashtu shkëmbim të dobishëm dhe thelbësor të pikëpamjeve mbi Mitrovicën.

Z. Schlagheck tha se palët kanë vendosur të vazhdojnë diskutimin pas takimit vijues të nivelit të lartë me një raund tjetër të konsultimeve që me siguri do të ketë prapë karakterin e “bisedimeve për përafrimin e qëndrimeve”